



Pranuar / Dorezuar Použeno / Predato Received / Delivered	28 - 06 2021	1 viti god year	
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org / Unit	In Prot In Prot Prot No.	Shtesa e Pisqeg Appendix	Sasna Kolicina Quantity
SKM/PAK	3323/2021		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.525/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bektashi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.525/2021 të datës 10.06.2021, të parashtruar nga ankuesi nga Fshati "Pataqan i Poshtëm", Komuna e Rahovecit, kundër organit të punësimit Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.525/2021 të datës 10.06.2021, e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Komuna e Rahovecit me datë 12.01.2021 shpall konkursin me numër 625/2021 për vendin e punës Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Dëshmorët e Lirisë" Pataqan i Poshtëm, në të cilin konkurse ka aplikuar edhe ankuesi Ankuesi i pa kënaqur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit për vendin e punës Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Dëshmorët e Lirisë" Pataqan i Poshtëm, me datë 13.04.2021 parashtron ankesën me numër 1477/2021 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Rahovecit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Rahovecit me datë 27.04.2021 merr Vendimin me numër të protokollit 1678 me të cilin vendim ankuesit i refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe e len në fuqi Vendimin me numër 286/2021 të datës 08.04.2021 të Kryetarit të Komunës dhe Rekomandimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues dhe e

këshillon palën që nëse është i pa kënaqur me këtë vendim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh mund të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e datës 27.04.2021 me numër të protokollit 1678 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Rahovecit, me datë 10.06.2021 parashtron ankesën me numër të protokollit 2997/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 10.06.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 02.06.2021; Padia e datës 07.05.2021 për iniciimin e kontestit të punës të parashtruar pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec/Departamenti i Përgjithshëm; Vendimi i datës 27.04.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Rahovecit; Njoftimi i datës 14.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka aplikuar në konkursin me numër 625/2021 të datës 12.01.2021 të shpallur nga Komuna e Rahovecit për vendin e punës „Drejtor” në Shkollën Fillore të Mesme të Ultës “Dëshmorët e Lirisë” Pataqan i Poshtëm, andaj bazuar në dispozitat ligjore të nenit 2 paragrafit 4 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”,* respektivisht në këtë kuptim, Kolegji ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike në fushën e arsimit, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve të **Shërbimit Publik**, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për shqyrtimin e ankesës vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.525/2021 të datës 10.06.2021, e parashtruar nga ankuesi

Pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi*



*administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.*

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.Nr. 525/2021**

**Valentina Kaçandolli BEKTESHI**

*Valentina Kaçandolli*  
Procesmbajtëse

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Rahovecit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Rahovecit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

